


RAPORT PARAPRAK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

(Hartuar sipas: VKM Nr. 912, date: 11.11.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore", Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011, te ndryshuar "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis")




“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS POGRADEC-TUSHEMISHT-DOGANË”

Zhvillues: Fondi Shqiptar i Zhvillimit



Hartoi Raportin Paraprak të VNM-së:

“GO GREEN STUDIO” Sh.p.k



RAPORT PARAPRAK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Objekti:

“Rikonstruksioni i rrugës Pogradec-Tushemisht-Doganë”

Zhvillues: *Fondi Shqiptar i Zhvillimit*

Vlerësimi Ndikimit ne Mjedis shtë përgatitur në përputhje me legjislacionin shqipëtar, "Për vlersimin mjedisorë" si dhe në legjislacionin e Bashkimit Europian që kerkohet per këtë lloj vlersimi.


Vlerësimi Ndikimit ne Mjedis është përgatitur nga “Go GREEN STUDIO” shpk

- *Licensuar nga Ministria e Financave dhe Ekonornise, LN-2235-10-2016 "Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis: Hartim i raporteve te ndikimit ne mjedis, kryerje e auditimit mjedisor; Hartimi i ekspertizave mjedisore. Thirrjen si ekspert per te vleresuar nje raport te V.N.M. dhe rezultatet e nje auditimi mjedisor."*
- *Certifikuuar prej Ministrise Mjedisit, Nr.5026 Prot. Nr. Identifikues 380, Tirane me 22.06.2017 "Ekspert mjedisi"*
- *Certifikuuar prej Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, Numri i Regjistrimit LT085, Tirane me 06.12.2018*
- *Licensuar nga Ministria e Financave dhe Ekonornise, LN-6792-02-2019 "Sherbime ekspertize. Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji".*


Bashkangjitur do te gjeni çertifikatat.



 <https://go-green.al>

 0355 69 74 87 976

 studio.gogreen@gmail.com / ismetkurti@gmail.com

 Rr. "Margarita Tutulani", Pall.29, Kati 1, Hyrja 31, Njesia Bashkiake nr.5, TIRANË

PËRMBAJTJA**Hyrje.....2****1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR**

- a) *Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se.....*
- b) *Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional.....*
- c) *Kuadri Ligjor nderkombetar.....*

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- a) *Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar edhe me fotografi;..... 6*
- b) *Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.....15*
- c) *Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer17*
- ç) *nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si: ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe per prodhimin e mbetjeve;.....18*
- d) *Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara;.....21*
- dh) *te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.....21*
- e) *mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin;.....21*
- ë) *masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis;22*
- f) *ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille);.....25*

➤ HYRJE

Ky Vlerësim Paraprak i Ndikimit në Mjedis është i përgatitur për projektin **“Rikonstruksioni i rrugës Pogradec-Tushemisht-Doganë”, në bashkinë Pogradec, me zhvillues shoqëria Fondi Shqiptar i Zhvillimit** dhe është pjesë e dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar për këtë projekt. Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM perdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e sheshit, se bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtarite të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qendrueshem
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i pergjegjesise së ndersjelle dhe bashkepunimit
- ❖ Parimi "Ndotsi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtes për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

➤ INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore
10. Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
11. Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
12. Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- ❖ Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- ❖ Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimit e pakthyeshme te mjedisit;
- ❖ Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit;
- ❖ Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit;

Pershkrim i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ❖ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- ❖ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kryhet aktiviteti;
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- ❖ Historiku i ndërveprimit mjedisor;

PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI:

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 'Per mbrojtjen e mjedisit', te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis', te ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura"
5. Ligi nr.10 253, date 11.3.2010 "Per gjuetine"
6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullisor te ndryshuar"
11. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit", te ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
14. VKM nr. 686, date 29.07.2015 'Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore';
15. VKM nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore"
16. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", te ndryshuar;
17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
18. VKM nr.175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve"
19. VKM nr. 371, date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme"
20. VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve neburim"
21. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"
22. VKM nr.519, date 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"
23. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kriterëve te administrimit te pyllit komunal"
24. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor"
25. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"

26. VKM nr.897. date 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes”
27. VKM nr. 532, date 05.10.2000 “Per miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin”
28. VKM nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”
29. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
30. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
31. VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te”.

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBETAR

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqsasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- ✚ Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- ✚ Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit ne fushën e politikës së ujrave.
- ✚ Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- ✚ Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshilit të Evropës (21 Maj 2008) ”Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- ✚ Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- ✚ Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- ✚ Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave te Planeve dhe Programeve te Caktuara mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva e Këshilit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- ✚ Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- ✚ Direktiva e Komisionit
- ✚ Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujrave te embla
- ✚ Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

➤ PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i infrastruktures së transportit rrugor, plotësimi të rritjes së nevojave për shërbimet e transportit brenda qelimit të ndryshimeve të shpejta ekonomike kombëtare dhe rajonale.





Segmenti rrugor Pogradec-Dogane Lot II fillon në afërsi të fshatit Bucimas, kalon në kodrinën rreth burimeve të Drilonit dhe përfundon në afërsi të fshatit Tushemisht. Rruga kalon në një terren të kombinuar fushor e kodrinor me formacione të paqëndrueshme dhe në prezencë ujërash nentokesore.



Seksioni TerthorTip

Hartimi I projektit do të realizohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit. Për këtë do të kryhen studime dhe matje topografike në terren. Do të kryhen studimet dhe matjet gjeologjike, hidrologjike dhe mjedisore për të studjuar problematikat aktuale dhe për të gjetur zgjidhje për to.

Punime germimi për zgjerim të kasonetes ekzistuese .

- Ndertim vepra arti si tombino rrethore dhe kuti, mure mbajtës apo prites sipasrastit.
- Punime për shtresatrrugore
- Punime për trajtimin e zonave të banuara me trotuare, korsi bicikletash, ndertim parking për makinat, ndricim ,gjelberim.
- Punime tesinjalistikes





Klasifikimi i Rruges

Standarti i projektimit të rruges, i përdorur nga Konsulenti si referencë për të gjitha çështjet që lidhen me parametrat gjeometrike dhe përcaktimin e gjurmës së propozuar të

Llojet sipas kodit	Shtrirja territoriale	Lim shpejtësisë	Nr i korsive për secilin drejtim	Lim i poshtëm (km/ore)	Lim sipërm (km/ore)	Gjer korsi	Gjer min. e bankinës në të djathtë (m)	Niv Sherb	Shtrirja sherbimit për kors	Gjer min trotuarve (m)	Percaktimi i ndalesave	Percaktimi i transve publike	Rregullimi trafikut të kemb	Hyrjet
--------------------	-----------------------	-----------------	----------------------------------	------------------------	---------------------	------------	--	-----------	-----------------------------	------------------------	------------------------	------------------------------	-----------------------------	--------

rruges, është Manuali i Ri i Projektimit të Rrugeve në Shqipëri, datë 30. 07.2015.

- Sipas përvojës që ka shoqëria jone, duke përdorur rregulloren e sipër përmendur, rruga do të përmbushë standartet me të larta përvoja të perket:

- Sigurisë;
- Kapacitetit;
- Sjelljes së Përdoruesve të Rruges;
- Shpejtësisë së Projektimit.

-Përvoja të perket funksionit kryesor që do të kryejë kjo rrugë, ajo I perket kategorisë F – Rruge urbane lokale.

Kategoria F përbehet nga një karrexhata me dy kors, bankine të shtruar në të djathtë. Rruga do të jetë e pajisur me trotuar dhe me kors bicikletash përgjatë zonave të banuara.

-Kategoritë e mjeteve që do të lejohet të përdorin rrugën e re janë:

- Motocikleta
- Autovetura
- Autobuse
- Kamione
- Mjete teartikular

KRITERET PËR GJURMEN HORIZONTALE

Shpejtësia e projektuar për këtë kategori rrugë do të jetë nga 40 deri në 100 Km/h .

Gjurma horizontale e rruges do të sigurojë një përdorim të sigurt dhe të vazhdueshëm, me një shpejtësi uniforme .

KRITERET PËR GJURMEN VERTIKALE

Pjerrësia maksimale gjatësore për një rrugë të kategorisë F është 7%. Rrezja minimale për kthesat vertikale do të jetë në përputhje me Manualin i Ri i Projektimit të Rrugeve në Shqipëri 2015.

2	3	4	5	6	7	8	11	15	16	17	18	19	20	21
F	F1	90	1	40	100	3.5	1	C (1 kors)	450	-	Lejohet ne vendet e ndalesave	Ndalesa te organizuara ne zona te vecanta ne ane terruges automobilistike	Ne Bankine	Lejohet
	F2	90	1	40	100	3.25	1	C (1 kors)	450	-				
	-	50	1 ose me shume	25	60	2.75	0.5	KAPACITETI (c)	800	1.5	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Vende per te ndaluar	Ne trotualet e mbrojtur	Lejohet

a) Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes bimore ku propozohet të ndërtohet projekti dhe fotografitë përkatëse.

Bregu i liqenit të Ohrit dhe pellgu i tij ujembledhës përben një habitat kritik për një shumëllojshmëri organizmash, ku përfshihen bretkosat, breshkat, dhe shpendet ujore të cilët varen drejtpërdrejt nga ujërat e liqenit. Kështu liqeni i Ohrit përben një zonë shumë të rëndësishme për shpendet ujore dimerues (IBA), përfshirë këtu lloje të rralla dhe të rrezikuara.

Duke patur parasysh këto vlera natyrore të këtij rajoni, me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 80, datë 18.2.1999, është shpallur zona e Prespës “Park Kombëtar” dhe zona e Liqenit të Pogradecit “Peisazh i mbrojtur tokësor/ujor”.

Se fundmi, në Shkurt të vitit 2009, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Kulturës, i kërkoi UNESCO-s përfshirjen e pjesës shqiptare të liqenit të Ohrit në Listën e Trashëgimisë Botërore.


Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ka një sipërfaqe prej 27.323 ha. Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë. Kufijtë e ZM-së

përcaktohen me Vendimin Nr. 80, datë 18.2.1999 “Për shpalljen e territorit tokësor/ujor të Pogradecit


“Zonë e mbrojtur”, si më poshtë:


- Veri Qafë Thanë: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë);
- Lindje: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe kufiri liqenor me Parkun Kombëtar të Prespës: (maja e Pusit: 2,288m, maja e Zonjës: 2,085 m) dhe kuotat 1,912 m;
- Jug: Kuota 1,912m, kuota 1,461 dhe kuota 1,589 m;

□ Perëndim: kuota 1,461, dhe kuota 1,589m, maja e Beshenikut (1,411m) maja e Shullerit (1,226 m), maja e Fushës së Madhe (1,430m), maja e Muratit (1,520), Qafa e Kotodeshit, Qafa e Thanës.



**Proposed extension of the "Natural and Cultural Heritage of the Ohrid region" World Heritage property
World Heritage property and the nominated property**





1. "Peisazhi i mbrojtur" shpallet një territor i madh me peisazhe harmonike dhe të formuara mirë me karakteristika të zhvilluara qartë, me një shumëllojshmëri ekosistemesh, detare ose toke, zona brenda të cilave mund të ketë qendra rezidenciale që zhvillojnë aktivitete si bujqësia, pemët frutore, pylltarisë dhe peshkimit.

2. "Peisazhi i mbrojtur" menaxhohet për të mbrojtur vlerat e peisazhit, biodiversitetin, rekreacionin dhe argëtimin. Kjo kategori përfshin ujërat tokësore / detare / publike ose private.

3. Në një "peizazh të mbrojtur" aplikohet shkalla e mbrojtjes që ka objekt kryesor:

a) fuqizimi i ndërveprimit harmonik të natyrës me kulturën për të mbrojtur cilësinë e peizazhit, shfrytëzimin tradicional të tokës, praktikat e ndërtimit dhe manifestimet shoqërore dhe kulturore, karakteristike të zonës;

b) mbështetja e atyre stileve të jetesës dhe aktiviteteve ekonomike që janë në harmoni me natyrën dhe ruajtjen e trashëgimie shpirtërore dhe kulturore të popullatës lokale;

- c) eliminimin, kur është e nevojshme, dhe parandalimin e përdorimit të tokës dhe kryerjen e aktiviteteve që janë të papërshtatshme në përmasa dhe / ose përmbajtje;
- ç) krijimin e mundësive për kënaqësi publike përmes rekreacionit dhe turizmit, në përputhje me karakterin dhe madhësinë e karakteristikave kryesore të zonës;
- d) inkurajimin e aktiviteteve shkencore dhe edukative që ndihmojnë në zhvillimin afatgjatë dhe mirëqenien e popullatës lokale dhe në sigurimin e mbështetjes së gjerë publike për mbrojtjen e mjedisit të këtyre zonave të mbrojtura;
- dh) të sjellë përfitime ekonomike dhe të kontribuojë në rritjen e mirëqenies lokale të popullsisë nëpërmjet përdorimit të produkteve natyrore, siç janë pyjet dhe prodhimi i peshkut dhe shërbimet si uji i pastër ose të ardhurat që rrjedhin nga format e duhura të turizmit.
4. Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e tokës si ndërtimet, trajtimi i ujërave të zeza në fermë, ndërtimi i autostradave, rrugët e lundrueshme dhe zonat urbane, dhe aktivitete të ngjashme lejohen të ushtrohen vetëm nëse entiteti që kërkon të kryejë veprimtarinë është i licencuar nga Këshilli Kombëtar Territorial.
5. Për ushtrimin e veprimtarive vijuese duhet të jenë të mjaftueshme: miratimi me shkrim i administrimit të zonës së mbrojtur mjedisore:
- a) Përdorimi i kimikateve dhe pesticideve për tokat bujqësore;
- b) ndezjen e zjarreve jashtë vendeve dhe pikave të caktuara;
- c) lëvizjen e automjeteve jashtë rrugëve të vendosura. Ky rregull nuk zbatohet për automjetet shtetërore, bujqësore dhe pyjore, makineritë, zjarrfikësit, ambulancat, makineritë veterinare dhe të menaxhimit të ujit;
- ç) organizimin e garave me automjete, motoçikleta dhe biçikleta;
- d) praktikën e përdorimit unik ose tradicional të tokës dhe organizimit social të shprehur në vendbanimet njerëzore, zakonet lokale dhe besimet fetare, pasi u është dhënë leje mjedisore.
6. Në planin e menaxhimit të peizazheve të mbrojtura sipas nënndarjeve të administratës, në mënyrë të qartë dhe të detajuar përcaktohen të lejuarit, ndalimet dhe ato për të cilat kërkohet leja e lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- Plani i Menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur Pogradec përcakton në Shtojcën 1; Kategoritë, nivelet e mbrojtjes dhe aktivitetet e ndaluara.

Kategoria	Zona e mbrojtur	Niveli i mbrojtjes	Aktivitete të ndaluara
V	Peisazh i mbrojtur	Niveli 4	Mbjellja e pemeve të kulturave të vetme; Neutralizimi i mbeturinave dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve të specifikuara; Përhapja e kafshëve dhe bimëve që vijnë nga jashtë; Gjuetia me ushqime helmuese; Ndërtimi i autostradave, kanalizimeve dhe zonave urbane; Qarkullimi me anë të mjeteve të transportit jashtë rrugëve të përcaktuara. Ky rregull nuk zbatohet për makinat e shtetit, makineritë bujqësore dhe pyjore, zjarrfikësit, ambulancat dhe makineritë për menaxhimin e mbeturinave dhe shërbimet veterinare; Organizimi i garave me makina, motoçikleta dhe biçikleta.

Qarkullimi me anë të mjeteve të transportit jashtë rrugëve të përcaktuara mund të kërkohet gjatë punimeve të ndërtimit. Kjo duhet të shmanget dhe duhet të gjenden zgjidhje alternative në lidhje me planin e menaxhimit mjedisor .




Gjurma e rruges se propozuar

Nder Monumentet e Natyres qe gjenden ne zone permendim:

- **Burimet e Drilonit:** Perfshin ligatinat rreth burimeve (2.5 ha) dhe nje pjese te pyllit (6.5 ha) qe rrethon ligatinat.
- **Shpella e Najzmes**

- Selvia e Kishes Fjetja e Shen Merise ne qytetin e Pogradecit
- Rrepet e Tushemishtit



FLORA

Sipas studimeve te bera flora e zones ndahet ne tre zona fitoklimatike: pyjet e dushkut, te ahut dhe kullotat alpine.

Zona e pyjeve te dushkut perfshin pjesen me te madhe te territorit deri ne lartesite qe variojne nga 600-1200 m mbi nivelin e detit. Kjo zone fillon nga kodrat e Linit dhe vazhdon deri ne Tushemisht. Me pas vazhdon me kodrat e Tushemishtit dhe te Alarupit.

Tipike per kete zone dominimi i disa specieve te dushkut sic jane: bunga (*Q. petraea*), bunge e bute (*Q. Pubescentis*), shparthi (*Q. frainetto*) te perzier me shkurresi shkoza (*Carpinus betulus*), melleza (*Ostria carpinifolia*) frasheri i bardhe (*Fraxinus ornus*) etj.

Zona e pyjeve te ahut ndodhen kryesisht ne lartesite 1900 m mbi nivelin e detit dhe jane te pranishem vetem ne zonen e Malit te Thate.

Zona e kullotave alpine gjendet kryesisht ne Mailn e Thate.

Bimesia ujore

Ne komunitetin pelagjik te liqenit te Ohrit, planktoni perben bazen e rrjetes ushqimore. Gjate viteve te fundit jane grumbulluar shume te dhena te cilat sugjerojne se komunitetet e fitoplanktonit dhe zooplanktonit ne liqenin e Ohrit po ndryshojne. Specie te reja, me karakteristike te ujerave te pasura me nutrienete jane zbuluar.

Ne pjesen shqiptare te liqenit te Ohrit jane te pranishme 25 lloje te fitoplanktonit: 5 krizofite, 4 cianofite, 3 diatome, 4 peridine, 11 klorofite.

Ne liqenin e Ohrit jane te pranishme dy lloj komunitetesh bimore dhe shtazore; ato te bregut ose komunitetet e zones litorale, dhe ato te thellesive ose komunitetet pelagjike ne mes te liqenit. Secili prej ketyre komuniteteve karakterizohet nga grupe te ndryshme organizmash.

Ne zonen litorale, jane te pranishme bimet me rrenje, qe rriten ne funde ranore dhe baltore, dhe algat qe rriten ne siperfaqet e shkembinjve dhe siperqe te tjera te forta. Keto bime shpesh ne zona te dallueshme pergjate bregut. Ne ujera me te thella (5-15 m) algat dhe bimet ujore me rrenje mund te zhvillohen ne zona te gjera duke formuar rripa bimore. Nder speciet me te zakonshme mund te permendim: *Potamogeton spp.*, *Chara spp.*, *Ceratophyllum spp.*, dhe *Myriophyllum spp.*

Me ne afersi te zones se bregut jane te pranishme kallamishtet (*Phragmites australis*), *Typhetum latifolia*.

Ne shume zona jane te pranishme ne siperfaqe algat koloniale *Cladophora*.

Zona e kallamishteve perfaqeson nje habitat shume te rendesishem per shume organizma perfshire peshqit, bretkosat dhe shpendet e ujit.

Ne zonat e bregut ku derdhen ujerat e lumenjve qe furnizojne liqenin, ujerat nga tokat bujqesore, komuniteti i zones litorale mund te jete shume pasur me bime ujore. Ne vecanti *Cladophora* mund te zhvillohet mjaft nga prania e fosforit.

Shume nga llojet bimore kane rendesi te madhe ekonomike si: *Trapa natans*, *Utricularia vulgaris*, *Vallisneria spiralis*, *Nyphea alba* etj.

Ne pjesen e ujerave te Drilonit paraqet interes lloji *Helodea canadensis*, e cila formo ne keto ujera nje popullate te dendur.

FAUNA

Molusqet

Sipas autorëve të ndryshëm, bota e gjallë e Liqenit të Ohrit karakterizohet nga endemizmi, për shembull, për Infusoret, *Rhabdacoela* dhe *Tricladida* (krimba të sheshtë turbelarianë): *Gastropoda* (molusk): *Ostracoda* (crustacean):

Shume nga organizmat qe jetojne ne fundet e liqenit jane endemike. Keshtu liqeni i Ohrit eshte vendi i vetem ku gjendet sfungjeri *Ochridospongia rotunda*. Llojet me te aferta me te gjenden ne

Baikal, nje tjeter liqen i vjeter. Me shume se 85% e moluskeve ne liqenin e Ohrit jane gjithashtu endemike. Pergjate 20-25 viteve te fundit komuniteti i i organizmave te vegjel ka ndryshuar ne menyre sinjifikative ne zonat ku eshte e pranishme ndotja njerezore. Ndikimet qe vijne si rezultat i ketyre ndryshimeve per peshqit dhe organizmat e tjere qe ushqehen me to eshte akoma e panjohur.

Peshqit

Peshqit qe jetojne ne ujerat e ceketa perfshijne peshqit si: (*Alburnus alburnus alborella*) dhe krapin (*Cyprinus carpio*). Gjate periudhes se riprodhimit, shume peshq te tjere vijne ne zonen litorale, duke perfshire dhe troften e liqenit te Ohrit (*Salmo letnica*). Keta peshq jane nje lidhje ndermjet habitateve e ujerave te ceketa dhe atyre te ujerave te thella.

.Nder speciet e peshqve mund te permendim: koranin (*Salmo letnica*), belushken (*Acantholingua (Salmothymus) ohridana*), (*Alburnus alburnus alborella*), krapin (*Cyprinus carpio*), ngjalen (*Anguilla anguilla*), dhe (*Rutilus rubilio ohridanus*).

Llojet e peshqve me rëndësi tregtare në Liqenin e Ohrit, sidomos korani i famshëm, janë gjuajtur në nivele të paqëndrueshme gjatë viteve të fundit. Për pasojë, popullatat e koranit jane në rrezik për t'u zhdukur. Veprimtaritë njerëzore gjatë bregut janë kërcënim edhe për terrenet e lëshimit të vezëve të dimërimit, si për koranin ashtu dhe për peshqit e tjerë, duke përfshirë gjuhçën dhe krapin.

Amfibet dhe Reptilet

Persa i perket amfibeve dhe reptile qe gjenden ne zone ta perbejne nje numer prej 25 llojesh nga 52 lloje gjithsej qe gjanden ne Shqiperi. Nder keto lloje 10 jane amfibe dhe 15 jane reptile. 5 lloje nga lista e amfibeve (*Triturus cristatus*, *Triturus vulgaris*, *Bombina variegata*, *Rana graeca*, *Rana balcanica*) dhe 2 lloje nga lista e reptileve (*Emys orbicularis*, *Natrix natrix*) te pranishem ne zone jane te lidhur ngushtesisht me mjediset ujore. Pjesa tjeter jane pjeserisht te lidhur me mjediset ujore ose jetojne ne stere.

Tab. Lista e llojeve te amfibeve te zones

Nr.	Emri latinisht	Emri shqip	Stat. Komb. i Ruajtjes
1.	<i>Salamandra salamandra</i>	E bukura e dheut	DD
2.	<i>Triturus cristatus</i>	Tritoni kreshtak	LRlc
3.	<i>Triturus vulgaris</i>	Tritoni rëndomtë	LRlc
4.	<i>Bombina variegata</i>	Bretkosa barkverdhë	LRcd
5.	<i>Bufo bufo</i>	Thithlopa	LRnt
6.	<i>Bufo viridis</i>	Thithlopa e gjelbërt	LRnt
7.	<i>Hyla arborea</i>	Verore	LRlc
8.	<i>Rana dalmatina</i>	Bretkosa kërcimtare	LRlc
9.	<i>Rana graeca</i>	Bretkosa e përrenjëve	LRnt
10.	<i>Rana balcanica</i>	Bretkosa zakonshme	VU

Tab. Lista e llojeve te reptileve te zones

Nr.	Emri latinisht	Emri shqip	Stat. Komb. i Ruajtjes
1.	<i>Lacerta viridis</i>	Zhapiu me tri viza	LRlc
2.	<i>Lacerta vivipara</i>	Zhapiu vivipar	LRnt
3.	<i>Podarcis muralis</i>	Hardhuca e mureve	NE
4.	<i>Podarcis taurica</i>	Hardhuca e barit	LRnt
5.	<i>Anguis fragilis</i>	Kakzoza	NE
6.	<i>Coluber jugularis</i>	Shigjeta e gjatë	LRlc
7.	<i>Coluber najadum</i>	Shigjeta e holle	LRcd
8.	<i>Coronella austriaca</i>	Gjarperi zi	LRnt
9.	<i>Elaphe longissima</i>	Bolla e shtepise	EN
10.	<i>Natrix natrix</i>	Gjarpri i madh i ujit	NE
11.	<i>Natrix tessellata</i>	Gjarpri i vogel i ujit	NE
12.	<i>Vipera ammodytes</i>	Neperka	LRnt
13.	<i>Emys orbicularis</i>	Breshkujza	LRnt
14.	<i>Testudo hermani</i>	Breshka e zakonshme	LRnt

Shpendet

Liqeni i Ohrit eshte nje nder zonat me te rendesishme te dimerimit per shpendet ne Shqiperi duke arritur numrin e 20.000 individeve. Numri i llojeve eshte i ulet duke variuar nga 13-17 lloje krahasuar me numrin e llojeve ne ligatinat e tjera te Shqiperise por abondanca e llojeve eshte e larte. Komuniteti i shpendeve te ujit dominohet nga bajza (*Fulica atra*) ndjekur nga rosat:

(*Netta ruffina*). Lloje te tjera te pranishme ne zone mund te permendim: kredharakun gushezi (*Podiceps nigricollis*), kredharaku i vogel (*Tachybaptus ruficollis*).

Nder kredharaket permendim karabullakun e vogel (*Phalacrocorax pygmeus*) i cili gjendet ne numer me te madh.

Ne kete zone ndodhen dhe lloje te rrezikuara si: pelikani kacurrel (*Pelecanus crispus*), Kryekuqe e vogel (*Aythya nyroca*), shqiponja e madhe e rosave (*Aquila clanga*), dhe shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*).

Gjitaret

Ne zonen e projektit ndodhen rreth 26 lloje nga 69 lloje gjitaresh qe gjenden ne Shqiperi. Ketu per fshihen lakuriqet 2 insectivore, 8 rodente, 6 karnivore dhe 1 lepur.

Zona strehon lloje te rrezikuara shtazore sic jane: lunderza (*Lutra lutra*) ariu (*Ursus actos*), ujku (*Canis lupus*), dreri (*Capreolus capreolus*), derri i eger (*Sus scrofa*) dhe rreqebulli (*Lynx lynx*). Gjithashtu ne zone jane te pranishme rreth 25 lloje te lakuriqve, te klasifikuar si te rrezikuara.


ENDEMIZMI

Liqeni i Ohrit eshte nje liqen i vjeter i formuar nga levizjet tektonike 2-3 milion vjet me pare gjate Terciarit. Ne liqen jane te pranishme nje shumellojshmeri e madhe bimore dhe shtazore, kjo nisur

nga fakti se liqeni eshte i vjeter dhe rrethohet nga male dhe kodra. Ne kete larmishmeri perfshihen nje numer i madh species “relike” dhe endemike te cilat gjenden vetem ne Liqenin e Ohrit.


Sipas autorëve të ndryshëm, bota e gjallë e Liqenit të Ohrit karakterizohet nga endemizmi, për shembull, për Infusoret: 88% e të gjitha llojeve janë endemike, *Rhabdacoela* dhe *Tricladida* (krimba të sheshtë turbelarianë): 44% dhe 71 % janë endemikë; *Gastropoda* (molusk): 90% endemik; *Ostracoda* (crustacean): 66% endemik; dhe peshku: 60% endemik.

Fauna e peshkut përfaqësohet nga 17 lloje autoktone në katër familje: *Salmonidae* (2 lloje), *Cyprinidae* (12 lloje), *Cobitidae* (2 lloje) dhe *Anguilidae* (1 lloj).



a) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e zënë nga projekti dhe në afërsi të tij.

Në bashkinë e Pogradecit ka përhapjen e akuiferëve të llojeve të ndryshme. Akuiferi karbonatik karstik zënë rreth 18 % të gjithë sipërfaqes së tij. Ato ndërtojnë pjesët më të larta malore si mali i Thatë etj. Akuiferët karbonatikë karstikë përmbajnë resurse ujore nënëtokësore shumë të mëdha dhe kryesorët për furnizimin me ujë të territorit të bashkisë. Akuiferët me porozitet ndërkokrizzor, kanë përfapje shumë të vogël dhe të kufizuar në bashkinë e Pogradecit dhe shtrihen në zonat fushore pranë liqenit. Ky akuifer zënë rreth 5% të territorit të bashkisë dhe shtrihet në zonën Buçimas-Pogradec dhe nuk paraqesin interes për furnizim me ujë. Akuiferi jo pak i rëndësishëm është edhe akuiferi me porozitet çarjeve me ujëmbajtje mesatare deri të ulët. Ky akuifer zënë një sipërfaqe rreth 12% të territorit të bashkisë dhe shtrihet në pjesën perendimore të liqenit të Ohrit. Në figurën më poshtë jepen sipërfaqet e tipeve të ndryshme të akuiferëve për bashkinë e Pogradecit.



Ujërat sipërfaqësore

Lumenjtë

Arteriet lumore kryesore, të bashkisë Pogradec janë: 1-Lumi i Shkumbinit që buron nga malësitë e Vallamarës dhe përshkon krahinën e Mokrës me të cilin në teritorin e bashkisë Pogradec bashkohen lumi i Llëngës, i Bishnicës, i Dushës, i Radicinës dhe dhjetra përrenj me burime në të dyja anët e luginës së tij; 2- Lumi i Çërravës; 3- Lumi i Drilonit; 4- Lumi i Rëmenjtit; 5- Lumi i Vërdovës; 6- Lumi i Qytetit dhe 7- Lumi Tërhanit.

Liqenet

Në territorin e bashkisë Pogradec liqenet, kanë vlera të veçanta nga lloji dhe origjina e tyre. Liqenet që ndodhen në këtë territor janë^{ix} : Liqeni i Ohrit (Pogradecit), Liqeni i Madh, Liqeni i Lukovës, Liqeni i Llëngës, Liqenet e Gur Topit.

Liqeni i Ohrit është formuar në periudhën e Pliocenit, me moshë 2-4 milionë vjeçare, duke u futur ndër katër liqenet me të vjetër të botës. Vendoset në lartësinë 695m mbi nivelin e detit me thellësinë mesatare 145m dhe atë maksimale që arrin 289m. Furnizimi kryesor me ujë i liqenit bëhet nëpërmjet rrugëve nëntokësore nga liqeni i Prespës, i vendosur 157m me lart, që dalin pranë bregut Shën Naum-Drilon me prurje të përgjithshme 15m³/sek. Rreth 26% e ujrave vijnë në liqen nga lumenjtë e përrenjtë që derdhen në të.

Në vitin 1999, me një vendim të Këshillit të Ministrave, pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Pogradecit merr statusin e zonës së mbrojtur. Në liqen, rriten 40 specie të rralla, ndër më të njohurat dhe ekonomikisht më të rëndësishmet është peshku i pastër i llojit *Salmo letnica* (Korani) dhe *Salmothimus ohridanus* (Belushka). Nentor 1979 pjesa maqedone e liqenit të Ohrit është shpallur trashëgimi natyrore botërore, (CC-79/CONF.003 /13 Paris, 30 November 1979), dhe në Shtator të vitit 1980 qyteti i Ohrit dhe pjesa maqedone e basenit të tij janë shpalluar trashëgimi kulturore botërore, (CC-80/CONF.016/10 Paris, 29 September 1980), nga UNESCO.

Liqenet e Lukovës - Liqenet e Lukovës gjenden në shpatin lindor të Malit të Gurit të Topit, në afërsi të fshatit Bishnicë të ish Komunës Velçan të Bashkisë së Pogradecit, rreth 80 km nga qyteti i Pogradecit, në lartësitë 1700m dhe 2027m mbi nivelin e detit. Janë dy liqene akullnajorë (Liqeni i Vogël dhe Liqeni i Madh).





c.) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitetin, ujë, tokë dhe ajër.

Ky raport hartohet mbi bazën e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendesimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndersjellë dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotësi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përberësve të mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e përbërësve të mjedisit klasifikohet në:

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujërave
- ❖ Mbrojtja e tokës
- ❖ Mbrojtja e natyrës
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky projekt do të ndërtohet në sipërfaqen ujore të plazhit të Golemit, ku pista që do të ndërtohet ndodhet 60 metra larg nga bregu i detit.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit.
- ❖ Në fazën e funksionimit.

Rendesi ka të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikime të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime ta pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
- ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
- ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuar.

Ndikimi mbi Dherat

Materialet e germuara që janë të menduara për rishfrytezim do të menaxhohen dhe levizën në minimum dhe do të depozitohen në mënyrë të tillë që të minimizohet efekti i motit. Gjate periudhave të zgjatura të lageshtires kontraktori do të ndalojë germimet dhe vendosjen e këtyre materialeve për të parandaluar degradimin për shkak të lageshtires.

Tabela. -1 Ndikimet dhe masat lehtësuese për, Gjeologjine dhe Dherat gjate ndërtimit

Veprimtaria	Burimet e ndikimit	Ndikimi	Magnituda	Masat Lehtësuese
<i>Ri-shfrytezimi i materialeve të dherave</i>	<i>Ndërtimi i rruges.</i>	<i>Zhurma dhe pluhuri që vjen nga transportimi i materialeve. Humbja e topsoil për shkak të transportimit dhe depozitimit të pasakte.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Dherat e germuar që duhet të perdoren për rimbushje do të transportohen dhe depozitohen sic specifikohet në dokumenta..</i>

Veprimtaria	Burimet e ndikimit	Ndikimi	Magnituda	Masat Lehtesuese
<i>Kontaminimi i dherave</i>	<i>Rrjedhjet nga makinerite e ndertimit</i>	<i>Derdhjet aksidentale te karburantit te automjeteve.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Masa te caktuara per kontrollin e ndotjes per tu zbatuar nga Kontraktori.</i>

Ndikimet gjate fazes se ndertimit per hidrologjine, ujerat siperfaqesore dhe nentokesore

Ekziston mundesia per ndotjen e ujrave nentokesore dhe siperfaqesore nga derdhjet e impiantit te ndertimit dhe derdhjet aksidentale te gazrave dhe karburanteve. Punimet e ndertimit do të bëhen përkohësisht në natyrë por kanë potencialin për të shkaktuar ndikime në mjedisin ujor. Shkarkimet e baltrave në kolonat e ujit gjatë ndertimit konsiderohen si një ndikim potencial negativ.

Ne ujerat nentokesore si rezultat i cpimeve dhe germimeve per themelet apo derdhjet aksidentale te karburanteve dhe vajrave gjate ndertimit nga makinerite e ndertimit dhe makinerite si rezultat i menaxhimit jo te mire te veprimtarive te ndertimit;

Gjate ndertimit mund te ndodhin impaktet e meposhtme te mundshme:

- ne ujerat nentokesore si rezultat i shpimeve dhe germimeve per themelet apo derdhjet aksidentale te karburanteve dhe vajrave gjate ndertimit nga automjetet e ndertimit dhe makinerite qe perdoren pa kriter gjate menaxhimit te veprimtarive te ndertimit;
- impakte ne ujrat siperfaqesore si rezultat keqmenaxhimit te veprimtarive te ndertimit.

Do te merren masa te pershtatshme per kontrollin e impianteve te cilat do te kryhen nga Kontraktori gjate ndertimit per te zvogeluar sa me shume impaktet.

Tabela-2 Permbledhje e ndikimeve dhe masave lehtesuese mbi ujerat siperfaqesore dhe nentokesore gjate ndertimit

Komponenti Prekur	Burimet e ndikimit	Ndikimi	Rendesia	Masat e lehtesimit
<i>Cilesia e ujerave siperfaqesore</i>	<i>Shkarkimi I te carave ne kanalet ujore/rrjedhjet.</i>	<i>Ulja e cilesise se ujit.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Ndertimi I rrethimeve me mur.</i>
<i>Cilesia e ujerave siperfaqesore</i>	<i>Ndotje te tjera te lidhura me aktivitetet e ndertimit qe do te hyjne ne rrjedha ujore.</i>	<i>Ulja e cilesise se ujit.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Masat e kontrollit te ndotjes qe do te vendosen aty gjate ndertimit.</i>
<i>Ujerat nentoksore gjate ndertimit</i>	<i>Nxjerrja e materialeve te siperfaqes do te rrite cenueshmerine e ujerave nentokesore.</i>	<i>Rritja e cenueshmerise se ujerave nentokesore.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Sigurimi I masave te duhura per konrollin e ndotjeve qe do te vendosen aty nga kontraktuesi gjate ndertimit</i>
<i>Ujerat nentoksore gjate ndertimit</i>	<i>Rrjedhje nga makinerite e ndertimit</i>	<i>Derdhjet aksidentale te vajrave dhe karburanteve te makinave.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Sigurimi I masave te duhura per konrollin e ndotjeve qe do te vendosen aty nga kontraktuesi gjate ndertimit</i>

Komponenti Prekur	Burimet e ndikimit	Ndikimi	Rendesia	Masat e lehtesimit
<i>Ujerat nentoksore gjate ndertimit</i>	<i>Copeza balte dhe argjili te mobilizuara nga rreshjet dhe aktivitetet e ndertimit.</i>	<i>Ndikim ne cilesine e ujerave nentokesore ne nje afersi te menjehershme te puneve te ndertimit.</i>	<i>E lehte</i>	<i>Sigurimi I masave te duhura per kontrollin e ndotjeve qe do te vendosen aty nga kontraktuesi gjate ndertimit</i>

Ndikimet mbi biodiversitetin, Flora dhe fauna

Tabela:3 Ndikimet e gjate fazes se ndertimit dhe masat lehtesuese

Burimi	Komponenti i prekur	Ndikimi	Rendesia	Masat e lehtesimit
<i>Kampi i punetoreve</i>	<i>Mjediset dhe llojet</i>	<i>Shkaterrimi dhe degradimi i habitateve natyrore, Humbje e biodiversitetit gjate ndertimit, Migrimi i popullates se kafsheve si shkak i shqetesimit, Krijimi i mjedisve te reja per llojet invazive</i>	<i>E vogel</i>	<i>Shmangia e kantierëve te ndertimit ne afersi te rrjedhave ujore, Punimet e ndertimit gjate sezonit te thate dhe jashte sezonit te celjes se zogjve Rehabilitimi i habitateve pas mbarimit te punes.</i>
<i>Mbetjet e ngurta dhe te lengshme nga kampi i punetoreve</i>	<i>Mjediset tokesore dhe vecanerisht mjediset ujore dhe fauna ujore, cilesia e ujit</i>	<i>Ndotja e tokes, Degradimi i habitatit, Humbjet e biodiversitetit, demtimi ose shkaterrimi I vendeve te riprodhimit te peshqve dhe specieve bentike.</i>	<i>E vogel</i>	<i>Krijimi i pellgjeve sedimentare, shmangia e punimeve ne rrjedhat ujore, mbledhja dhe riciklimi i mbetjeve te ngurta dhe te lengshme ne kantierin e ndertimit .</i>
<i>Rrjedhje e karburanteve /lubrifikanteve te makinerive</i>	<i>Mjediset tokesore dhe vecanerisht mjediset ujore dhe fauna ujore</i>	<i>Ndotja e tokes, Degradimi i habitatit, Humbjet e biodiversitetit, demtimi ose shkaterrimi I vendeve te riprodhimit te peshqve dhe specieve bentike.</i>	<i>E vogel</i>	<i>shmangia e punimeve ne rrjedhat ujore masa per te shmangur rrjedhjen aksidentale te lubrifikanteve dhe karburanteve, mbledhja dhe riciklimi I lubrifikanteve, punimet e ndertimit gjate sezonit te thate.</i>
<i>Zhurma</i>	<i>Shpendet, gjitaret, amfibet, zvarraniket</i>	<i>Migrimi i popullates se kafsheve si pasoje e shqetesimit, Reduktim i suksesit riprodhues ne afersi te rruges.</i>	<i>E vogel</i>	<i>Vendosjen e pigrjeve te dheutte mbjella per te minimizuar ndikimin e mundshem te zhurmes tek kafshet e egra</i>
<i>Lekundjet</i>	<i>Te gjithë grupet e faunes</i>	<i>Migrimi i popullates se kafsheve si pasoje e shqetesimit, Reduktim i suksesit riprodhues ne afersi te rruges.</i>	<i>E vogel</i>	<i>S'ka masa lehtesuese.</i>

Burimi	Komponenti i prekur	Ndikimi	Rendesia	Masat e lehtësimit
<i>Ndricimi</i>	<i>Te gjithë grupet e faunes</i>	<i>Migrimi i popullates se kafsheve si pasoje e shqetesimit, Reduktim i suksesit riprodhues ne afersi te rruges.</i>	<i>E vogel</i>	<i>S'ka masa lehtesuese.</i>
<i>Shkarkimet e gazeve</i>	<i>Te gjithë grupet</i>	<i>Largimi I perkohshem nga zona, Reduktim i suksesit riprodhues ne afersi te rruges.</i>	<i>E vogel</i>	<i>S'ka masa lehtesuese.</i>
<i>Pluhuri</i>	<i>Te gjithë grupet</i>	<i>Degradimi i mjediseve, reduktim i burimeve te ushqimit per llojet e faunes.</i>	<i>E vogel</i>	<i>Sperkatja me uje e rruges gjate sezonit te thate.</i>
<i>Depozitimi i materialeve te germuara</i>	<i>Habitatet ujore</i>	<i>Shkaterrimi dhe degradimi i habitateve, Largim i faunes,</i>	<i>E vogel</i>	<i>Kryerja e punimeve gjate sezonit te thate.</i>
<i>Furnizimi me materiale inerte</i>	<i>Habitatet ujore dhe tokesore</i>	<i>Shkaterrimi dhe degradimi I habitateeve, Largimi i faunes, Dëmtimi ose shkaterrimi I vendeve te riprodhimit te peshqve dhe llojeve bentike</i>	<i>E vogel</i>	<i>Mos shfrytezimi i materialeve inerte nga lumenjte .</i>
<i>Nxjerrja e ujit</i>	<i>Habitatet ujore</i>	<i>Shkaterrimi dhe degradimi I habitateeve, Largimi i faunes, Dëmtimi ose shkaterrimi I vendeve te riprodhimit te peshqve dhe llojeve bentike Monitorimi i cilesise se ujit, Monitorimi i indikatorëve biotike ujore</i>	<i>E vogel</i>	<i>S'ka masa lehtesuese.</i>
<i>zjarri i rastesishem (i paqellimshem)</i>	<i>Bimesia tokesore</i>	<i>Shkaterrimi dhe degradimi I mjediseve, Humbja e biodiversitetit, Migrimi I popullsisë se kafsheve si pasoje e shqetesimit.</i>	<i>E vogel deri ne mesatare</i>	<i>Shmangia e zjarrit ne vendin e punes gjate sezonit te thate.</i>

NJE PERSHKRIM PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS, TE TILLA SI: UJERA TE NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PER PRODHIMIN E MBETJEVE

CILESIA E AJRIT

Ndikimi gjate fazes se ndertimit

Faza e ndertimit te projektit "Rikonstrukcioni i rruges Pogradec-Tushemisht- Dogane" eshte nje burim i mundshem i emetimeve te PM qe mund te kene nje efekt te perkohshem mbi cilesine e ajrit ne zonen e vendndodhjeve te ndertimit.

Gjate fazes se ndertimit emetimi i pluhurit eshte i lidhur me aktivite te ndryshme si psh largimi i pemeve dhe i shtreses se puneshme, germimi i materialit tokesor dhe vendosja e te njejtit material ne argjinatura dhe ne ndertimin e strukturave. Emetimi i pluhurit varet separi ne kushtet e motit dhe ne nivelin e aktivitetit dhe te llojit te veprimtarise qe po kryhet. Gjithashtu pluhuri ngrihet nga rrotat e automjeteve te renda te ndertimit ndersa ato kalojne pergjate vendit te ndertimit gjate kushteve te motit te keq.

Humbja e materialeve nga rezervat qe mbahen zakonisht ne kushte te hapura per shkak te nevojës per akses te vazhdueshem tek to nga ekskavatorët dhe ngarkuesit etj. Emetimi I pluhurit nga keto materiale rezerve mund te dale si shkak i ketyre aktiviteve:

- Formimi i rezervave duke perdorur metodat e rripit transportues;
- ndikimi i ererave te forta; dhe
- ngarkimi i kamioneve per transport ne kantieret e ndertimit.

Ne rruges ne fjale, zonat qe do te vuajne me shume per shkak te emetimit te mundshem te pluhurit gjate ndertimit jane ato te afer rruges. Megjithate rekomandohet qe vezhgimi I cilesise se ajrit ne zonat perreth vendeve ku eshte ndermarre ndertimi gjate procesit te ndertimit ne menyre qe te shfaqet sa me heret te jete e mundur cdo problem qe del nga emetimet si pasoje e procesit te ndertimit. Por duhet te theksohet se menaxhimi i mire i kantierëve te ndertimit dhe planifikimi i punes duhet te organizohet ne nje menyre te tille impaktet nga shkarkimet ne ajer te minimizohen sa me shume ne nje periudhe te shkurter kohore.

ZHURMAT

Ndikimi gjate fazes se ndertimit

Emetimet e zhurmës nga zonat e ndertimit, duke marrë parasysh që puna ndërtimore do të kryhet duke përdorur makineri të mëdha dhe pajisje të tjera, mund të provokojë disa shqetësime, mbi të gjitha për disa marrës të afërt me operacionet më të zhurmshme, si piling etj.

Shkarkimet e zhurmave mund të krijohen nga shumë operacione të ndertimit dhe varen nga shumë faktorë si p.sh. lloji i pajisjes, modelet specifike, operacionet që duhet të kryhen dhe gjendja e pajisjeve dhe mjeteve të përdorura.

Burimi dominues i zhurmës për shumicën e pajisjeve të ndertimit është motori, në përgjithësi me naftë dhe pa zhurmues. Në disa raste, të tilla si për makineri për përgatitjen e pilotave ose një shpues pneumatik betoni, zhurma e prodhuar nga veprimi i punës është dominues.

MBETJET URBANE DHE INERTE

Largimi nga ana e Kontraktorit i materialeve brenda kufijve të kantierit dhe menjëherë jashtë kantierit do të monitorohet për të siguruar se jepet vlerësimi i duhur për largimin e të gjitha mbetjeve.

Largimi i të gjitha mbetjeve të tjera do të bëhet vetëm në vendet e përcaktuara zyrtarisht.

Në rast se ndodh ose ka të ngjarë që të ndodhë ndonjë lloj derdhjeje, ose aksidenti me çfarëdo lloj materiali të rrezikshëm ose të dëmshëm për ambjentin, FSHZH do të njoftohet menjëherë.

Asistencë e plotë do t'i jepet stafit nga FSHZH, i cili do të jetë përgjegjës për të siguruar pajtueshmëri me rregullat ekzistuese dhe specifikimet teknike mjedisore.

ç) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.

Duke iu referuar tipologjisë së ndërtimit që do të përdoret për realizimin e projektit të propozuar, nuk pritet të kemi ndikime të konsiderueshme në zonën dhe mjedisin përreth.

Shkarkimet e mundshme në mjedis gjatë fazës së ndërtimit

Emetimet në ajër

Emetimet në ajër pritet të vijnë nga përhapja e pluhurave nga mjetet e transportit, gjatë kohës që do të bëhet transportimi i lëndës së parë që do të përdoret për procesin e punimeve në objekt. Gjatë kohës që do të bëhet shkarkimi i lëndës së parë, mjetet e transportit do të jenë të fikura, kështu që emetimi i pluhurave në ajër do të jetë në nivele shumë të ulëta.

Gjithashtu emtimet në ajër mund të vijnë gjatë germimit të tokës për hapjen e themeleve, si dhe nga djegia e lëndës djegëse të mjeteve.

Për të patur një ndikim sa më minimal në mjedis, nga ana e subjektit ndërtues do të përdoren pajisje dhe mjete pune me kushte të mira teknike. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme do të bëhet kontrolli i kushteve teknike të këtyre mjeteve për të shmangur dhe parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve në mjedis, emetimin e elemnetëve ndotës të gaztë, si dhe për parandalimin e ndonjë avarie të mundshme teknike.

Shkarkime në ujë

Gjatë fazës së punimeve nuk pritet të ketë shkarkime në ujë. Sheshi i ndërtimit ku është propozuar ndërtimi i objekteve të banimit ndodhet larg ujërave sipërfaqësore të bashkisë së zonës, si rrjedhojë nuk pritet të kemi ndikime negative në këto ujëra.

Zhurmat dhe vibrimet

Nivele të gjenerimit të zhurmës dhe vibrimeve pritet të shkaktohen kryesisht nga përdorimi i pajisjeve të rënda, duke përfshirë mjetet e transportit për transportin e lëndës së parë apo mjeteve të tjera të punës të cilat do të përdoren gjatë fazës së punimeve. Mjetet e transportit do të

qarkullojnë në orare të përshtatshme dhe të lejuara në zbatim dhe konform rregullave e legjislacionit ligjor në fuqi, për të shmangur në maksimum shqetësimin e banorëve dhe pushuesve të zonës përreth. Nuk do të shkaktohen vibrime shqetësuese gjatë punimeve.

Nëse ndodh që të ketë prani të lartë të nivelit të zhurmave, punëtorët do të pajisen me masa mbrojtëse.

Për të shmangur krijimin e një trafiiku të mundshëm në zonë nga mjetet e transportit, do të merren masat e nevojshme për menaxhimin në kohë të tij.

Nuk do të shkaktohen vibrime shqetësuese për komunitetin përreth, gjatë fazës së punimeve.

Ndikimet ne biodiversitet

Zona ku është propozuar ndërtimi i objekteve të banimit është një zonë urbane, ecila karakterizohet nga një bimësi e varfër, kryesisht e pranishme është bimësia e kultivuar. Duke qënë se zona ku është propozuar ndërtimi paraqitet me një diversitet të dobët të florës dhe faunës, zbatimi i projektit nuk do të shkaktojë dëmtim të biodiversitetit apo të ndikojë në fragmentizimin e habitateve.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet inerte që do të gjenerohen gjatë procesit të punimeve do të menaxhohen në zbatim të legjislacionit në fuqi., do të bëhet largimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe do të depozitohen në vendet e përcaktuar nga Pushteti Vendor. Një sasi e vogël e mbetjeve që mund të krijohet nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve, të cilat do të grumbullohen nëpër kosha me ngjyra duke realizuar diferencimin e tyre që në burim he në fund të ditës do të depozitohen nëpër koshat e vendosura nga bashkia.

Ndikimet e mundshme gjatë funksionimit

Ajri

Objekti në fjalë do të shërbejë si objekt banimi dhe shërbimi, si dhe nuk do të ketë procese ku është e nevojshme përdorimi i lëndëve djegëse. Sistemi i grohjes dhe ftohjes do të jetë me ajër të kondicionuar.

Ujrëat

Ujrat që do të dalib nga aktiviteti human në objekt janë ujera urbane të cilat do të shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zonës.

Zhurmat

Sic është përmendur edhe më lart objekti është me funksion banimi dhe shërbimi, si rrjedhojë nuk do të ketë gjenerim të zhurmave gjatë funksionimit.

Mbetjet

Mbetjet të cilat do të krijohen gjatë funksionimit, do të jenë kryesisht mbetjet urbane të cilat do të gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i banorëve. Mbetjet e krijuara do të grumbullohen dhe depozitohen në vendet e përcaktuara nga Pushteti Vendor.

d.) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara

Kohëzgjatja e ndikimeve është një nga faktorët e marrë në konsideratë për përcaktimin e rëndësisë së tyre. VNM dallon ndikimet e përhershme nga ato të përkohshme si më poshtë vijon:


Ndikimet të përhershme janë ato të cilat rezultojnë nga ndryshim i pakthyesëm në mjedisin bazë ose të cilat do të përsëriten në një të ardhme të parashikueshme.

Ndikimet e përkohshme janë ato të cilat vazhdojnë vetëm për një periudhë të kufizuar; për shembull ato që lidhen me aktivitetet e ndërtimit ose mund të zhduken për shkak të mbulimit natyror të mjedisit ose asimilimit të tyre brenda tij. Efektet e përkohshme ndahen në:

afatshkurtra (me një kohëzgjatje më pak se një vjeçare),

afatmesme (nga 1 deri në 5 vite),

afatgjata (nga 5 deri në 20 vite).



dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Janë trajtuar gjithashtu efektet mjedisore në një masë të gjerë dhe/ose kontekst strategjik. Këto përfshijnë si më poshtë vijon:

Kriteret e Rëndësisë për Vlerësimin e Ndikimeve të Projektit perara masave lehtësuese

<i>Fjalor i ndikimeve</i>	<i>Niveli i rëndësisë</i>	<i>Kriteret</i>
<i>I thellë ose rëndësishëm</i> <i>Ndikimi: vetëm negativ</i>	<i>rëndë</i>	<i>Këtij niveli rëndësie i atribuohen vetëm ndikime të pafavorshme pasi përfaqësojnë faktorë kyç në procesin e vendimmarrjes. Këto efekte janë në përgjithësi, por jo ekskluzivisht, të shoqëruara me pozita dhe veçori të rëndësishme kombëtare dhe rajonale. Një ndryshim në pozitën ose veçorinë e shkallës rajonale ose krahinore gjithashtu mund të futet në këtë kategori. Në përgjithësi, masat lehtësuese nuk mund t'i zhdukin efekte të tilla.</i>
<i>Ndikim rëndësishëm</i> <i>Pozitiv ose Negativ</i>	<i>I madh</i>	<i>Këto efekte janë të rëndësishme dhe duhet të merren në konsideratë në një shkallë lokale ose krahinore, por, nëse janë të pafavorshme, janë shqetësime potenciale për Projektin dhe mund të bëhen faktorë kyç në procesin e vendimmarrjes. Masat lehtësuese dhe punimet e projektimit të detajuar zor se mund të heqin të gjitha efektet mbi komunitetet ose interesat e prekura.</i>
<i>Ndikim Mesatar</i> <i>Pozitiv ose Negativ</i>	<i>Mesatar</i>	<i>Këto efekte, nëse janë të pafavorshme, të rëndësishme në shkallë lokale, nuk duhet të jenë çështje kyç në vendimmarrje. Megjithatë, efekti i grumbulluar i këtyre çështjeve mund të çojë në një rritje në të gjitha efektet në një zonë të veçantë ose në një burim të veçantë. <i>Ato përfaqësojnë çështje ku efektet do të mund të përmirësojnë/shtojnë disa pasoja mbi komunitetet ose interesat e prekura. Mund të shfaqen disa efekte të tjera.</i></i>
<i>Ndikim i lehtë</i> <i>Pozitiv ose Negativ</i>	<i>I ulët</i>	<i>Këto efekte mund të ngrihen si çështje lokale por nuk konsiderohen të rëndësishme në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, ato kanë peshe ne ecurinë e Projektit dhe në marrjen në konsideratë të masave lehtësuese ose kompesuese.</i>
<i>I pandjeshëm</i>	<i>Jo domethënës</i>	<i>Asnjë efekt ose ato që janë nën nivelin e perceptimit, brenda kufijve normalë të ndryshimit ose diferencës së gabimit të parashikuar.</i>

e.) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.

Një pjesë themelore e procesit të VNM është reflektimi i rezultateve të tij në projektim dhe në proceset e vendim-marrjes. Rruga më efektive e aplikimit të masave lehtësuese është paraqitja e tyre në Projekt. Pas identifikimit të ndikimeve potenciale të pafavorshme të rëndësishme ato paraqiten në projekt me qëllim që, aty ku është e mundur, ato të mund të lehtësohen deri sa efektet e mbetura mendohet të jenë “aq të ulëta sa të praktikueshme në mënyrë të arsyeshme” (ALARP). Rendi përsëritës “parashikim-vlerësim-lehtësim” është thelbi i VNM dhe i projektit. Ky rend gjithashtu mund të zbatohet për identifikimin e mundësive pozitive (parashikim-vlerësim-zgjerim).

Principi i ALARP është më i zbatueshëm në kontekstin e adresimit të efekteve individuale. Duke përcaktuar se çfarë është ‘në mënyrë të arsyeshme praktike’ është diçka që grupi i VNM nuk mund ta arrijë i vetëm. Faktorë të tillë si siguria, realizueshmëria teknike, ndertimi dhe funksionaliteti, të gjitha bashkë luajnë rol kryesor në ALARP. Faktori tjetër kyç është kostoja. Duke përcaktuar ALARP për një masë ndikimi/lehtësimi, raporti kosto/përfundim duhet të merret në

konsideratë. Adoptimi i nje qasje sa me sistematike për identifikimin e masave lehtësuese me qëllim plotësimin e synimeve dhe standarteve të projektit, si dhe për të zbatuar parimin e ALARP, mund të ndihmojë shumë. Forma më efektive e lehtësimit është hartimi i Projektit në mënyrë të tillë që të shmange dëmin mjedisor. Negativiteti i një ndikimi i cili nuk mund të shmangët plotësisht mund të reduktohet (në ALARP). Kur një ndikim është reduktuar në ALARP, por ende mbetet i rëndësishëm, ai mund të kompensojë dëmin nëpërmjet disa mekanizmave korrigjuese ose, nëse jo, ta kompensojë atë nëpërmjet mënyrave të tjera. Edhe kur nuk ekziston asnjë ndikim i pafavorshëm, shumë projekte ofrojnë mundësi për të pasuruar mjedisin duke përmirësuar kushtet mjedisore ose duke krijuar veçori të tjera mjedisore.

Modeli i **Shmangies - Reduktimit - Zvogëlimit-Korrigjimit-Kompensimit-Shtimit** ofron një strukturë të dobishme për zhvillimin e një liste verifikimi të opsioneve të masave lehtësuese dhe ilustron si më poshtë:

Shmangia në burim. Duke shmangur në burim do të thotë 'hartimi' i Projektit në mënyrë të tillë që veçoria që shkakton një ndikim të jetë parashikuar (p.sh. duke shmangur një kantier për vendin e ndërtimit),

Reduktimi në burim. Duke reduktuar në burim do të thotë ndryshimi i projektit në mënyrë të tillë që një ndikim të reduktohet (p.sh. duke ulur lartësinë e një strukture të ndërfutur vizualisht ose duke reduktuar marrjen e tokës).

Zvogëlimi në kantier. Kjo përfshin shtesën e masave lehtësuese në projektimin bazë për të reduktuar ndikimin (p.sh. interceptorët e vajit ose larësit e gomave në një kantier ndërtimi, pengesat e zhurmës për rrugën operative).

Zvogëlim në receptor. Nëse një ndikim nuk mund të reduktohet në vend atëherë masat mund të implementohen nga jashtë kantierit (p.sh. instalimi i dritareve me dopio xham në pronat që preken nga zhurma, ose ndërtimi i një gardhi rreth pronës së banuar për t'i ofruar pamje vizuale).

Korrigjimi ose kompesimi. Disa ndikime përfshijnë dëm të pashmangshëm në një burim (p.sh. marrja e tokës në vendbanime natyrore ose dëmi i zgjidhjes në pronat e listuara). Në thelb korrigjimi përfshin masat e restaurimit dhe të rivendosjes.

Kompesimi në lloj ose kompesimi nëpërmjet mënyrave të tjera. Aty ku lehtësimi nuk është i mundur ose plotësisht efektiv, atëherë kompesimi për humbjen ose dëmin mund të jetë i përshtatshëm (p.sh. duke krijuar një vendbanim të ri kudoqoftë për të zëvendësuar atë çka ka humbur, kompesim financiar për humbje të përkohshme të kënaqësisë ose duke marrë përsipër regjistrime, dokumentacion dhe ruajtje të produkteve arkeologjike të nxjerra përpara zhvillimit).

Menaxhimi I Mbetjeve

Gjate kryerjes së punimeve nuk parashikohet të kemi mbetje të rrezikshme, por edhe nëq ka kontraktori duhet të marrë të gjithë masat për magazinimin e asgjësimit të tyre mbeshtetur në VKM nr 371 datë 11.06.2014

Mbetjet inerte do të menaxhohen në bashkëpunim me bashkinë Pogradec, mbetje do të depozitohen në zonën e caktuar. Një pjesë e këtyre mbetjeve do të sistemohen në sheshin e ndërtimit pas përfundimit të punimeve. Do të përdoret për mbushje të aneve të themeleve, për sistemimin e sheshit dhe sipërfaqet e gjelberta.

Mbetjet e ngurta nga punimet e ndertimit do te jene kryesisht ato inerte te cakullit dhe shtreses se humusit dhe shtresa bimore dhe e tokes e cila do te pastrohet per sheshin e ndertimit.

Në bazë të VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, mbetjet e ngurta qe do te prodhohen ne kete zone do te jene mbetje te tilla si: 17 02 03 plastike, 17 02 02 qelqi, 15 01 01 materiale letre e kartoni, 17 04 07metale, 17 02 01 mbetje organike (paleta druri), 17 09 04materiale inerte te prodhuara nga punimet si dhe mbetje që perfshihen ne kategorine e KODIT 17 05 Dhera (duke perfshire dhera te germuar nga toka te kontaminuara, gure dhe balta te tjera) dhe nenkategorine e tij:

- Kodi 17 05 04: Dhera dhe gure, te tjera nga ato te permendura ne 17 05 03;
- Kodi 17 05 08: Çakell,te tjera nga ato te permendura ne 17 05 07;
- Kodi 17 09 04: Mbetje te perziera nga ndertimi dhe te prishjeve;

Bill n°1 : Punimet e prishjes dhe punime germim mbushje				
Nr	An	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia
1	An.1	Shkallim shtresa ekzistuese asfaltike + transport auto, sipas profilave terthore	m ²	510.00
2	3.110/b	Germim dheu me ekskavator zingjir. 1.0 m ² , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m ³	29,175.00
3	3.124/2a	Germim shkemb i forte me çekiq me ekskavator me rinxhir	m ³	2,116.00
4	An.124/3a	Germim shkemb sek i lire, me mina te vogla me ekskavator 1 m ³ + transport	m ³	58,960.00
5	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ² , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m ³	43,721.00
6	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	75,012.00

Studim Projektim "NDERTIMI I RRUGES LIDHESE "POGRADEC - DOGANE " (LOTI - II)"				
Bill n°3 : Tombinot dhe Sistemi I Drenimit				
Nr	An	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia
Tombino Ø1500				
1	3.95/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ² , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke, per tombinot	m ³	4,005.00
2	3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m ³	4,005.00
Tombino Box				
1	3.95/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ² , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke, per tombinot	m ³	1,909.00
2	3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m ³	1,909.00

Sasia e dheut dhe inerteve qe parashikohet te dale gjate punimeve eshte 80929 m³

Shumica e e kesaj sasje do te perdoret ne punimet mbushese

Depozitim i mbetjeve inerte të bëhet ne venddepozitim në baze te udhezimeve te Bashkise Pogradec dhe ne perputhje me VKM Nr.575,date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”.Transporti i mbetjeve inerte të bëhet me mjete teknologjike të pajisur me liçensë të tipit III.2.B në bazë të ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës I të VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

Bashkia Pogradec, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të zbatimit të projektit personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, paraqet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kopje të dokumentacionit që provojnë përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi. Subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së. Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga NJQV-ja, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të këtij vendimi, në lëndfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, NJQV-ja konfiskon garancinë financiare.

ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Gjatë ndërtimit, Kontraktoret e rrugës do të duhet të përgatisin një plan mjedisor, i cili do të sigurojë që:

- Pemët me vlerë të mbrohen;
- Materialet e gërmuara që synohen të ri-përdoren do të zhvendosen në një minimum;
- Periudha e kohës ndërmjet gërmimit dhe ri-përdorimit të materialeve të gërmuara gjatë periudhave të thata do të mbahet në një minimum;
- Gjatë ndërtimit do të zbatohen masat e duhura për kontrollin e ndotjes;
- Cilesia e ujit në puset që ndodhen në afërsi të pronave të kontrollohet periodikisht.
- Punimet që kryhen në afërsi të rrjedhave ujore të jenë minimale;
- Të krijohen basene të përkohshme për të mbledhur llumrat;
- Mbetjet e ngurta dhe të lëngëta të mblidhen dhe/ose riciklohen;
- Punimet e ndërtimit do të kryhen kryesisht gjatë sezonit të thate
- Zona e përkohshme e magazinave dhe fjetoreve të punëtorëve do të rikthehet për përdorimin e mëparshëm (tokë bujqësore, tokë natyrore, etj.);
- Platforma e rrugës dhe rruget e aksesit të përkohshëm të lagen gjatë periudhave të thata për të evituar pluhurat;
- Furnizimi me ujë, energji, dhe rrjeti i kullimit do të mbahen në funksionim gjatë ndërtimit. Nevojat e kantierit të punimeve për ujë dhe elektricitet të plotësohen pa demtuar aksesin publik në këto burime.

Faza e Ndertimit

- *Furnizimi me Materiale:* Kontraktoreve do ti kerkohet te perdore ose te bleje materiale nga operator qe kane leje mjedisin te vlefshem dhe licensat e tjera. Garancite e duhura per kete efekt do te jepen ne dokumentat e kontrates.
- *Transporti i materialeve:* Punonjesit e kamioneve do tu kerkohet te mbulojne ose te lagin ngarkesat e kamioneve, terheqin materialet jo ne oret e kulmit te trafikut, dhe te perdorin rruge alternative per te minimizuar ngjeshjen e trafikut. Kontraktorit do t'i kerkohet te pergatisi dhe ti jape mbikqyresit te punes nje plan manaxhimi trafikut qe tregon rruget dhe kohet qe mund te perdoren per te shperndare materialet ne dhe prej vendit te punes.
- *Zhurma dhe pluhuri:* Kontraktoreve te ndertimit do tu kerkohet te kufizojne aktivitetet per ne oret me dite (jo ndermjet 23.00 dhe 7.00 ose sipas marreveshjes me publikun dhe autoritetet) dhe te perdorin pajisjet qe largojne zhurmat. Sheshet e ndertimit dhe sheshet e grumbullimit te materialeve do te lagen me uje atehere kur duhet per te kontrolluar pluhurin.
- *Nderprerja e trafikut dhe siguria e automjeteve/kembesoreve:* Kontraktoret do te pergatisin nje plan manaxhimi te trafikut me masat e duhura per te ridrejtuar trafikun.
- *Eliminimi I mbeturinave te ndertimit:* Asfalti I prishur dhe mbeturinat prej prishjeve nga sheshi I ndertimit do te eliminohen ne perputhje me udhezimet per mjedisin lokal dhe ne vendet e aprovuara prej autoritetit lokal.
